

# Ballkani: Kjo Perandori e Madhe

Nga Ylli Permeti

*Është fakt tashmë, që ajo që thuret apo intrigohet tek ne politikisht apo shoqërisht e njëjta gjë ndodh diku tjetër dhe e kundërta. Mëndja e njëriut është e njëjtë kudo.*

Ballkani me 550 km<sup>2</sup> dhe 53 milione banore kalon sot, momente historike. Greket e lashte e quanin si gadishulli Haemus (**Αἴμος**), nga personifikimi i mbretit të Trakes bir i Voreit dhe i nimfes Orithias. Edhe sot në Greqishten moderne nuk mungon nga tekstet e literatures shkrimore dhe shprehese. Gjithashtu, nuk mungojne analizat etimologjike të këtij emri; në këte vazhde po i hedhim një kendveshtim. Greket kishin për prirje që të gjithë emrat gjeografike, pra toponimet por edhe emrat e njerezve t'i greqizonin, për një arsye të vetme: gjuhës greke i mungon pershtatshmeria apo e thënë ndryshe sipas rregullave të gjuhësise: struktura e saj nuk lejon rrokezimin e emrave të huaj sipas rregullave fonetik origjinardhes. Kështu, fjales -Αἴμος- i është shtuar 's' -ja në fund. Diftongu 'ai' lexohet sic dihet si në zanoren e shqipes 'e'. Rrenja e saj derivon nga nga fjala 'gjak' qofte në greqishten e vjeter qofte në të rene. Leksikografi dhe rektor' i Universitetit të Padios në Athinë Jorgos Babinjoti, këte fjale etimologjikisht e pershkruan si të pasigurt dhe e përngjan me fjale të tjera të sanskritishtes apo gjermanishtes. Por Traka sic dihet, ka qene e banuar në atë periudhë nga Iliret dhe natyrisht emrat kanë qene Ilir. Kështu, në një variant Ilir mund të themi se kjo fjale fonetikisht -- është pranë shprehjeve të sotme shqipe, si psh: 'ee mo' dhe të tjere zera si ky. Edhe sot në Shqipëri gjen emra me të njëjten fonetike, pra Emo. Herodoti (485 - 421/415) pra burim i këtij emri gjeografik si historian dhe gjeograf fliste greqisht, kështu që i duhej që të merresh vesh me bashkeqytetaret e tij. Studiues të tjere e lidhin me fjalen trakiane 'saimon' që do të thote vargmal. Sidoqofte, kjo përjasje ka nevojë për analize me të thelle dhe ajo që ka rendesi është që ky gadishull sot quhet ballkan nga fjala Turke 'balkan' që do të thote mal. Nderkohe, Romaket e quanin si Gadishulli Ilir dhe me vone Iliro-helen. Në periudhën Bizantine por dhe para saj, kjo perandori Ilire shtrihesh pothuajse në të gjithë Ballkanin e sotem. Vargmali nga qendra e Bullgarisë deri në lindje të Serbisë ndoshta ka qene edhe fillesa ku të paret e kanë quajtur me këte emer. Por kjo s'do të thote që shqiperise

apo vendeve te tjere ne rajon u mungojne malet.

Kjo qasje u be, per arsye se shume bashkkohe nuk e dine origjinen e emerit te gadishullit nga ne vijme. Por gjithsesi, ne nuk do t'perqendrohemi ne te kaluaren por ne tashmen dhe kryesisht ne te ardhmen. Ky tekst, do t'ngrej shume pyetje dhe do jap shume pergjigje. Per qoke ky tekst ka nje analize te thelle dhe si ngacmim kritike ka fashikullin e gazetes greke Kathimerini, te dates 28 Prill 2008. Ne qender te vemendjes kjo analize ka Maqedonine, Kosoven, Shqiperine e Madhe dhe garen SH.B.A dhe Rusi ne rajon. Autoret jane nga te gjitha trevat: ne qender te vemendjes eshte historiani Serb Traian Stoianovich me vepren e tij te vitit 1994, Balkan Words: The First and the Last Europe. Ne kete veper historike ky historian hedh drite ne mitet e krijuara ne rajon nga indigjenet. Shkruajne, ministrja e jashtme Dora Bakojani, ministri jashtem i Serbise Vuk Jeremic dhe gjithashtu Kyeministiri' Kosoves Ashim Thaci. Kryeministri i Bullgarise Sergei Stanishev, presidenti i Kroacise Stjepan Mesic dhe shume te tjere: politologe, publiciste, gazetar, profesore dhe analiste te rajonit. Pra plote, 48 faqe. Qendrimet e tyre jane pothuajse te nje shkollë: duhet te shohim perpara dhe te integrohemi sa me shpejte ne kthinat e B.E. Ka dhe nga ata, si psh, Vuk Jeremic qe mbeshtet frymen e kishes serbe apo publiciste greke qe mbeshtetin gjithashtu frymen eklisiastike greke -- per frike ndaj nje ekspansionizmi te shqiperise se madhe. Pergjithesisht, qasjet e tyre jane te verfera: mbeshteten ne te njetet instrument te se kaluares per zhvillimin e rajonit, pra besim, fe selektive, dogma pratiake, mungese vizioni dhe te shohim perpara me instrumente qe jane tashme te vjeteruar pra, regjime kompetitive qe sjellin gjithnje paqendrueshmeri, dominance, bashkepunim uni/bi/multilateral, pushtete qe mbeshteten vetem ne propagande duke mbikqyrur tregun te cilin e sajone vete ata duke u mbeshtetur ne njuhurite e tyre deshtake/dekadente te perendimit.

Keto mendesi me pak fjale udheheqin kongregacionin sikurse shume permendet ne shtypin botere kjo fjale dhe e ka origjinen ne simbolin e domokracise te se ardhmes Martin Luther King. Kete humbes te lirise, e bashkangjisin dhe e paralelizojne me Obamen, tashme i emeruar si president i Amerikes. Ne nje debat publik te rradhes, per median Angelze pak dite me pare, u hodh nje teze: cfare duhet te bej Anglia ne te ardhmen; a duhet ajo te ndryshoj vektor politike, pra te jete pjese e koalicionit politike monetar europiane? Te ftuar sic dihet jane proponent politike te dy kraheve: laburiste vs konservator. Keshtu ngjet, ne Shqiperi, ne Greqi dhe me tej dhe njerezit te

tuhafur nuk kuptojne asgje. Natyrisht, eshte me se normale qe te ndjehen te tille: vete proponent ne debatin e siper-permendur nuk kishin mundesi te pershkruanin asnje nen, klauzole, projekligj apo vete kushtetuten europiane. Asnje s'e ka marre mundesine t'a analizoj as ne shqiperi apo edhe me tej. Pyetje ne lidhje me kushtetuten pra se cfare permban ne thelb ky afidavit nuk i behet asnje politikani, sepse pyetjet jane te para-menduara, pra censuruara. E thene ndryshe, do me pyesesh per pyetjet qe une di dhe jo per ato qe une s'di. Ne dabatin e mesiperm, politikanet ishin te cilter: ne nuk e kemi lexuar por do t'a lexojme ne te ardhmen dhe do t'u informojme kur te kemi nje ide rreth kushtetutes Europiane. Dmth, prit gomar te mbij bar. Por kush jane keta hartues te kushtetutes Europiane dhe c'fare kane shkruajtur ne te? Sipas profesorit te te drejtes nderkombetare dhe kritike i ashper i kushtetutes Europiane Joseph Weiler, lexojme:

*'[K]ushtetuta europiane është një procedurë teorike ligjore konstitucionale në të cilën nuk është përpunuar: largpamësia e saj; vlerat transedente s'janë elaboruar mjaftueshmërisht; elementët e saj ontologjik janë keqkuptuar; ngultësia dhe legjitimiteti i saj kanë kontigjencë (rastësi) të një niveli të lart'.*

Kjo eshte vetem maja e ajzbergut: kemi ne njeren ane nje kushtetute europiane qe calon dhe nuk merr per baze vlerat njerezore pra lokale te sendertuara keto ne shekuj dhe ne anen tjeter propangadistet tane qe shesin dhe blejne jetet tona. Kemi nje mit te ri qe po n'a e indoktrinojne njelloj si afidavitet biblike: kuran, bibel etj, dhe kemi nje kohesisht nje mit tjeter qe mbeshtetet nen ombrellen Europano-Atlantike: t'i fusim te gjithë qytateret ne nje rregull te ri dhe t'u japim atyre ate qe duan, pra pseudo-demokraci. Gjithkush qe beson se jeton ne demokraci, sheh endrra me sy hapur. Gjithkush qe beson se duke u future ne B.E dhe problemet do te zhduken si me magji, zhgenjehet. Shohim sot gjithë ngrehinen e ekonomise se monetarizmit ne Pernedim me udheheqese Ameriken dhe ferkojme syte. C'do gje eshte ne zgrip katastrofal. Dhe nese vazhdojme te besojme dhe te rekrutohemi neper parti atehere do te zhgenjehemi tragjikisht. Kushdo qe mendon se kesaj analize i mungon propozimi -- edhe ate e kemi ne maje te gjuhes: bojkotoni partite, bankat qe jane sponsoret e partive, bojkotoni zgjedhjet, bojkotoni televisionet qe jane mjet propagandues i te gjithë games sociale, bojkotoni mjetet e komunikimit masive, qendroni larg huave bankare, huate jane mjet skllaverimi, dhe kthehuni ne organizimet bashkiake dhe u jepni zgjidhje ceshtjeve tuaja duke i diskutuar ato ne nivel lokal. Eshte e thjeshte dhe e qarte: jeta kerkon sakrifice qe te permiresohet, ndryshe do te

kalbemi nen tutelën e dogmave dekadente. Harta që përvijon këto tekst janë strategjitë që po thuhet fqinjët tanë, pra një hapësirë gjeografike me të madhe. Këto teza janë të indoktruara në ç'do shkollë dhe universitet lokal në rajon, ato demonstrojnë sëmundjet tona të pavdekshme, pra për një serbi me të madhe, për një grek me të madhe etj, dhe Europa në thurjen e saj konstitucionale ka vasale që i shërbejnë vetëm një vlere: parase dhe vetëm asaj. Kushtetuta europine në thelb ka -- njëjtesimin e vlerave dhe trasendentimin e të vetmes vlere që është praraja që udhëheqë të gjitha mendjet e udhëheqësve tanë. Dominique Strauss-Kahn Drejtor i Fondit Nderkombëtar Monetar e tha qartë: ne kemi nevojë për institucione globale që këto krize t'a menaxhojnë me efektivitet. Sa mundësi ka një institucion qoftë edhe i lart-përmenduri të menaxhojë krizën që ata vetë kanë skater -- kjo është një çështje tjetër që përgjigjet do t'i japim në shkrimet e rradhës.